

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
PËR SHITIMIN E KAPACITETEVE PËR PRODHIMIN E BLLOKAVE
DHE ELEMENTEVE TJERA TE NDËRTIMIT QE DALIN
NGA ARGJILA**



**NE ZONËN KADASTRAVE PIRANË
PARCELA - P-71813064-02087-0, 02088-0, 02089-0, 02090-0, 02091-0, 02092-0,
02093-0, dhe 02094-0 KOMUNA E PRIZRENIT
"RIZAM Holding" SH.P.K.,**

Aplikuesi:

"RIZAM Holding" SH.P.K.

Prizren – 2024

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Lokacioni i impiantit për prodhimin e bllokave është në njësinë kadastrave P-71813064-02087-0, 02088-0, 02089-0, 02090-0, 02091-0, 02092-0, 02093-0, dhe 02094-0 në zonën kadastrale Piranë ne komunën e Prizrenit

Aplikuesi: “RIZAM Holding” SH.P.K.

Adresa: Piranë, Prizren

Përfaqësues; Ali Morina

Adresa e impiantit: Piranë, Prizren

Tel: 044837435

E-mail: rizam_holding@hotmail.com

info@rizamholding.com

Hartuesi i raportit:

Email: astrit-shala@hotmail.com

Tel: 044800098

Adresa: Prishtinë

Hartuesit;

Dr. Sc. Astrit Shala

Dr.sc. Selim Frangu

Prizren – 2024

Përmbajtja:

1	. HYRJE.....	5
2	. KUADRI LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT	6
2.1	Metodologjia e punës.....	7
3	. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT	8
3.1	Përshkrimi i mjedisit	8
3.2	Potencialet ekzistuese	8
3.3	Pozita gjeografike e lokacionit	9
3.4	Popullata dhe vendbanimet.....	11
3.5	Lidhjet e Komunikacionit.....	12
3.6	Kushtet klimatike.....	12
3.6.1	Reshjet	12
3.6.2	Erërat	13
3.7	Natyra dhe biodiversiteti	13
3.8	Flora dhe vegjetacioni	13
3.9	Fauna	14
3.10	Peizazhi.....	15
3.11	Karakteristika Gjeologjike të Rajonit te gjerë	15
3.12	Karakteristikat hidrologjike	17
3.13	Trashëgimia natyrore në Prizren	19
3.14	Asetet e Trashëgimisë Kulturore.....	20
4	. PROCESIT TEKNOLOGJIK I PRODHIMIT Dhe objektet	21
4.1	Objektet – pajimet.....	21
4.1	Përshkrimi i procesit teknologjik.....	21
4.1.1	Punimet në terren	22
4.1.2	Përpunimi mekanik i argjilave.....	22
4.1.3	Formimi i brumit	23
4.1.4	Tharja	24
4.1.5	Pjekja	25
4.1	Paisjet e Prodhimit.....	26
4.2	Parimi i punës	30
4.3	Tharja - terrtorja	31
4.4	Kontrollimet	31
4.5	Transporti në tersë.....	32
4.6	Pjekja – FURRA	33
4.7	Lëndët e para materialet ndihmëse dhe të tjera	35
4.8	Ndikimet në ajër	37
4.9	Ndikimet në tokë	37
4.10	Ndikimet në ujë	38
4.11	Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë.....	39
4.12	Ndikimi në vendbanime dhe popullatë.....	39
4.13	Ndikimi nga zhurma	39
4.14	Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	40
5	. MASAT PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE NË MJEDIS	42
5.1	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër.....	42
5.2	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë.....	42
5.3	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë	43
5.4	Masat për mbrojtjen nga Zhurma	45
5.5	Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet.....	45
6	. PROGRAMI I MONITORIMIT	47
7	. RAPORTIMI	47
8	. MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT.....	47
9	. KONKLuzion	48

Lista e Figurave:

Figura 1. Lokacioni i kompanisë nga komuna e Prizren-it.....	10
Figura 2. Parcelat te cilat shfrytëzohen nga "Rizam Holding" Shpk.	10
Figura 3. Pamje e lokacionit nga ortofotot.	11
Figura 4. Ortofoto pamje nga lokacioni ku është impianti ne fjale dhe distanca me shtëpitë me fshatin.....	11
Figura 5. Harta gjeologjike e lokacionit.....	17
Figura 6. Harta hidrologjike e zonës.....	19
Figura 7. Marrja e argjilës ne terren.	22
Figura 8, Presa për formimin e prodhimeve argjilore.	24
Figura 9. Furra për pjekjen e produkteve te argjilës.	26
Figura 10. a) presa dhe b) hinka e presës.	26
Figura 11. Komora e ajrit(Vakumi i dheut).....	27
Figura 12. Presa (Kërmilli i Madh).....	27
Figura 13. a) Presa (Kallëpi i Prodhimit) dhe b) Teli (Tavolina e Prerjes).	28
Figura 14. a) pulti komandues i presës kaldaja dhe b) rrotulluesit.	28
Figura 15. a) elevatori –pjesa e jashtme dhe b) pulti komandues i rrotullueses, elevatorit dhe landerenit.....	28
Figura 16. a) FIBER BANI – (Pjesa transportuese) dhe b) Bnari 1.	29
Figura 17. a) kolloseku dhe b) shiperbina (në hymje të furrës).....	30
Figura 18. a) presa dhe b) pulti komandues i presës.	31
Figura 19. a) hyrja e furrës b) distributoret e ajrit.	33
Figura 20. a) Ventilatorët e furrës (riciklimi i ajrit) dhe b) pulti komandues.....	34
Figura 21. Distanca ne mes te L.Drini dhe impiantit.....	38
Figura 22. Skica gropës septike e cila është ndërtuar.	44
Figura 23. Skema e trajtimit te ujërave (kjo skam është ndërtuar tani).....	45

1. HYRJE

Ndërmarrja “RIZAM Holding” është kompani prodhuese e cila me veprimtarinë e saj ka filluar që nga viti 1989. Në vitin 1989 kane ndërtuar dhe ne Qershor të këtij viti fillon me punë Mulliri për bluarjen e grurit në Mamushë nën firmën RIZAM - Mulliri i Ri.

Në vitin 1997 në Mamushë ndërtohet fabrika për prodhimin e thasëve nga polipropileni me titull POLITEKS. Ishte e para dhe gati e vetmja e cila furnizonte me thasëve tërë tregun e ish Jugosllavisë. Në vitin 2000 në Krushë të Vogël ndërtohet Separacioni i parë privat i cili separonte dhe përpunonte zhavorr. Gjatë viteve 2006 - 2008 në Krushë të Vogël ndërtohet Fabrika e parë private në Kosovë për prodhimin e materialit ndërtimor prej argjile IZOBLLOK.

Kjo fabrike posedon gjithsej 9-të lloje të produkteve nga argjila (IZOBLLOK 31, Blloku G-5, Blloku Gj. G-5, Blloku për mure ndarëse 12, Oxhak 0160, Oxhak 0180, Oxhak 0200, Tavanore/Monta-14, Kanalore) ku 3 nga produktet (IZOBLLOK 31, OXHAK 0 200 dhe KANALORE) është e vetmja fabrike me prodhim në vende, gjithashtu kjo fabrike është e certifikuar nga TUV AUSTRIA HELLAS dhe ISO STANDARDS 9001.

Ndërsa kompania ka planifikuar të rrisë kapacitetin e prodhimit të këtyre materialëve ndërtimorë siç është blloku nga argjila dhe elementeve tjera ndërtuese.

Për këtë arsyeje kompania ka iniciuar procedurat për marrjen e pëlqimit mjedisore pranë Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës. Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis për prodhimin e bllokave, i cili është investim i kompanisë “RIZAM Holding”, me lokacion në komunën e Prizrenit, në vendin e quajtur Piranë, është përgatitur sipas kërkesave të legjislacionit mjedisor të Kosovës, veçanërisht sipas Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181.

Prodhimi i bllokove është një pjesë e rëndësishme e sektorit të ndërtimtarisë në Kosovë, dhe është zhvilluar paralelisht me kërkesat e këtij sektori dhe rritjen e eksportit të Kosovës pasi që kompania tash e njëzet vite eksporton jashtë vendit këto produkte.

Kompania ka iniciuar hartimin e raportit të VNM-së për të identifikuar ndikimet e mundshme në mjedis, me qëllim të ndërmarrjes së masave të nevojshme dhe zgjedhjen e alternativave për minimizimin e ndikimeve negative në mjedis.

Të dhënat për hartimin e raportit janë siguruar nga burime të ndryshme, literaturë ekzistuese, ueb faqja e komunës në fjalë, raportet e ndryshme mbi vlerësimin e aktiviteteve të ngjashme, dhe gjithashtu janë realizuar disa vizita në vendin ku bëhet investimi, me qëllim të njohjes me zonën, me pajimet, objektin, procesin teknologjik dhe infrastrukturën në lokacion.

Lokacioni i impiantit për prodhimin e bllokave është në njësinë kadastrave

P-71813064-02087-0, 02088-0, 02089-0, 02090-0, 02091-0, 02092-0, 02093-0, dhe 02094-0 në zonën kadastrale Piranë ne komunën e Prizrenit.

2. KUADRI LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT

Duke marr në konsideratë karakteristikat e projektit, madhësinë e shtrirjes së tij, ndikimet e mundshme në mjedis si dhe vendndodhjen, ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe i përket shtojcës së dyte pika 5. Industria e mineraleve, nënpika 5.6, e Ligjit Nr. 08/L-181. për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar ligje te tjera relevante, si:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji nr. 08/l-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (2023)
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025 (2022)
- Ligji për Mbeturinat Nr.08/L-071 (2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 (2012) për mbeturina
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji nr. 08/l-214 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/l-163 për minierat dhe mineralet i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/l-158
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11 7
- Ligji për kimikate Nr. 04/L-197
- Ligji për mbrojtjen nga zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012
- Ligjit Nr. 03/L-138, për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr. 02/L-89 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë

Udhëzimet Administrative:

- Udhëzimi administrativ Nr.04/2022 për Lejen Mjedisore
- Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2021 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes
- Udhëzimi administrativ për administrimin e mbeturinave të rrezikshme (06/2008)
- Udhëzimi administrativ Nr. 20/2012 për export, import dhe transit të mbeturinave
- Udhëzimi administrativ kompetencat e zotëruesit dhe operatorit për trajtimin e mbeturinave (08/2 Udhëzimi administrativ Nr. 20/2011 për Pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme
- Udhëzimi administrativ Nr. 20/2011 për metodologjinë e zvogëlimit të rrezikut nga aksidentet kimike dhe masat për eliminimin e pasojave.
- Udhëzimi administrativ Nr. 07/2012 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës.
- Udhëzimi administrativ për menaxhimin e deponive të mbeturinave(15/2012)
- Udhëzimi administrativ. Nr. 02/2022 përkushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese te shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor.

2.1 Metodologjia e punës

Për të vlerësuar ndikimin në mjedis si dhe për të identifikuar masat para parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, për impiantin për prodhimin e bllokave, është ndjekur qasja e vlerësimit të përgjithshëm të projekteve të kësaj natyre, si dhe është bërë analiza dhe identifikimi i ndikimeve sipas fazave.

a) Informatat themelore mbi:

- Burimet themelore të ndikimeve në mjedis
- Popullatën dhe vendbanimet në lokacion
- Topografia dhe peizazhi në lokacionin e projektit
- Klima dhe të dhënat meteorologjike
- Kualiteti i ajrit ujit dhe komponentëve tjerë mjedisor në lokacion
- Bota bimore dhe shtazore në lokacionin e projektit

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas kritereve në vijim:

- Gjendja e mjedisit në lokacionin e projektit
- Lloji dhe madhësia e pritshme e ndotjes nga projekti
- Karakteristikat dhe përbërja e materialit ndotës
- Vlerësimi i përhapjes së ndotjes

c) Përcaktimi i masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, duke u bazuar në rezultatet / të gjeturat nga vlerësimi i ndikimeve në mjedis, në lokacionin e projektit.

3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

3.1 Përshkrimi i mjedisit

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e Raportit.

Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë terren. Për t'u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për t'u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

Mjedis ku do të ndërtohet ky impiant është zone industriale e cila është kompanisë Rizam Holding, dhe rrjedhimisht nuk paraqet ndonjë problem në aspektin e planifikimit mjedisor.

Rëndësia e veçantë e këtij projekti është, pos tjerash, në zhvillimin e ekonomisë komunale të Prizrenit. Një ndër prioritetet në realizimin e këtij projekti është krijimi i vendeve të reja të punës, furnizimi i bizneseve me produkte vendore dhe rritja e eksportit në nivel vendi.

3.2 Potencialet ekzistuese

Njëri nga elementet kyç të hulumtimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më të gjerë të lokacionit ku është planifikuar të ndërtohet impianti, në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësitë e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre.

Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyrorë si që janë toka, uji, ajri, reliefi, flora dhe fauna.




Figure 1. Raportet themelore ndërmjet faktorëve natyrorë dhe potencialeve ekologjike.

Çdonjëri nga potencialet ekologjike në këtë mënyrë posedon funksione të caktuara, që në esencë kanë rëndësi të dorës së parë analizën e problematikës së tërësishme të mbrojtjes së

mjedisit. Ndikimi i ndërsjellë i faktorëve të veçanët si dhe ndikimi i tyre në formimin e potencialit ekologjik dhe i funksioneve të tyre themelore me interes për analizën në fjalë, së bashku me kompleksin e marrëdhënieve të mundshme është paraqitur në figurën nr.1. Në bazë të raporteve të paraqitura në figurën 1. është e qartë që faktorët natyror formojnë disa potenciale natyrore karakteristikat funksionale të cilave duhen marrë parasysh gjatë valorizimit të ndikimit në mjedis të impiantit të planifikuar të ndërtohet në hapësirën konkrete.

3.3 Pozita gjeografike e lokacionit

Komuna e Prizrenit është njësi administrative në pjesën jugorë perëndimorë të Kosovës në pozitën gjeografike 42° 13' 0" Veri 20° 44' 0" Lindje. Komuna e Prizrenit është njësi administrative në pjesën jugore të Kosovës, me një sipërfaqe prej 640 km² (5.94% të territorit të Kosovës) gjendet në jugperëndim të Kosovës dhe me 76 vendbanime dhe me 178.112 banorë nga të cilët në Prizren janë rreth 120.000 banorë.

Sipërfaqja e kësaj komune është 361 km² që mbulon 3.3 % të territorit të Kosovës. Nga sipërfaqja e komunës, që përfshin 36.099 ha (ose 361 km²), prej tyre 15.074 ha ose 41.7 % janë të mbuluara me pyje, 19.373 ha ose 53.7 % janë tokë bujqësore dhe 1.652 ha ose 4.6% sipërfaqe tjetër.

Nëpër territorin e kësaj komune, me një pozitë të mirë gjeografike, kalojnë rrugë shumë të rëndësishme që e lidhin kryeqendrën, Prishtinë, me qendrën regjionale Ferizaj, Peje, Gjakove dhe kalojnë më tej në Shqipëri. Si e tillë ajo ka një pozitë të rëndësishme strategjike në këtë pjesë të Kosovës.

Ndërsa, ndërmarrja investuese "RIZAM Holding" SH.P.K. është ndërmarrje private e specializuar për prodhimin e produkteve nga argjila. Kjo ndërmarrje, ka një traditë shumë vjeçare në prodhimin e produkteve nga argjila.

Lokacioni i impiantit për prodhimin e bllokave është në njësinë kadastrave P-71813064-02087-0, 02088-0, 02089-0, 02090-0, 02091-0, 02092-0, 02093-0, dhe 02094-0 në zonën kadastrale Piranë, që gjendet në anën e majte të magjistrals Prizren – Gjakove rreth 16.2 km nga Qyteti i Prizrenit, ndërsa largësia e parcelës nga rruga magjistrale është 250 [m], ndërsa nga vendbanimet largësia është mbi 160 [m].

3.4 Popullata dhe vendbanimet

Njërën nga veçoritë qenësore të hapësirës së analizuar, në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis, e paraqet popullata dhe demografia e saj. Këto fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë në hulumtimin e hollësishëm të ndikimeve të mundshme negative në banorë që jetojnë në hapësirën e analizuar.

Ndërsa në afërsi të drejtpërdrejtë me lokacionin ku planifikohet të ndërtohet impianti kompanisë, ekzistojnë objekte të banimit me një distance mbi 170m. Në afërsi të zonës së projektit ndodhen një numër i konsiderueshëm i objekteve industriale. Lokacioni gjendet mbi 10km në jugperëndim të qendrës së qytetit të Prizrenit.




Figura 3. Pamje e lokacionit nga ortofotot.

Kur është në pyetje raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis përveç që duhet të kemi parasysh procesin teknologjik, gjithsesi duhet të kemi gjithmonë edhe vendbanimet për rrethë zonës ku ushtrohet veprimtaria.



Figura 4. Ortofoto pamje nga lokacioni ku është impianti në fjalë dhe distanca me shtëpitë me fshatin.

3.5 Lidhjet e Komunikacionit

Baza e kompanisë “Rizam Holding” SH.P.K. në lokacionin në Piranë ka lidhje të mira komunikimi me qendrat tjera në Kosovë, e cila lidhet me rrugën regjionale Prizren–Gjakovë dhe përmes autostradës Ibrahim Rugova lidhet me qendrat tjera të Kosovës si, Prishtinë, Pejë etj. Kjo lidhje e mirë komunikacionit rrugor kësaj kompanie i ka mundësuar zhvillimi në afërsimin e shërbimeve të tyre e sidomos pas periudhës së tranzicionit dhe ka ofruar mundësi eksporti përmes. Përveç kësaj kompanie, krahas kërkesave në treg vlerën e saj e mundësoj qasje dhe lidhja e mirë në komunikacionin rrugor për qasje të shpejtë në tregje vendore dhe rajonale.

3.6 Kushtet klimatike

Duke ju referuar të dhënave meteorologjike nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, në territorin e Komunës së Prizrenit mbizotëron klimë kontinentale me ndikim mesdhetar. Reshjet vjetore në rajonin e Prizrenit arrijnë në 760 mm dhe temperatura mesatare e ajrit është 11.87 °C, që është vlera më e lartë në Kosovë. Temperatura mesatare mujore më e lartë paraqitet në muajin korrik prej 22.27 °C dhe gati e njëjta është edhe në muajin gusht (22.09) Temperatura mesatare mujore më e ulët paraqitet në muajin janar 0.18 °C, por ajo njëherit është temperatura më e larta mesatare e dimrit në Kosovë. Amplituda mesatare vjetore është 22.09 °C. Lëkundjet termike prej vitit në vit janë mjaft të theksuara. Vlerat ekstreme maksimale janë shënuar deri në 39 °C, që njëherë paraqet edhe vlerën ekstreme termike në Kosovë, kurse ato ekstreme minimale prej -23.3 °C. Kështu vlerat ekstreme termike në Prizren arrijnë deri në 62.3 °C. Me rritjen e lartësisë mbidetare temperatura e ajrit bie. Në viset e larta malore temperatura mesatare maksimale në gusht është rreth 22 °C, kurse temperatura mesatare minimale në janar është -8.0 °C. Kështu në pjesët malore amplitudat vjetore termike janë më të vogla dhe arrijnë rreth 14 °C.

Tabela 1. Paraqitja tabelore e disa parametrave klimatik të këtij lokaliteti

Muajt	J	SH	M	P	M	Q	K	G	Sh	T	N	DH
Temperaturat mesatare mujore	0.18	2.89	6.46	11.87	16.7	20.23	22.27	22.09	17.99	12.08	7.36	2.49
Diellzimi mesatar në ditët (h/d)	2.0	3.4	4.6	5.9	7.8	8.5	9.8	9.5	7.3	5.3	2.8	1.8

3.6.1 Reshjet

Reshjet atmosferike për rajonin e Prizrenit janë analizuar për stacionin meteorologjik të Prizrenit. Në Prizren mesatarisht në vit bien 747 mm reshje që është nën mesataren e reshjeve vjetore në pellgun e Drinit të Bardhë (962 mm) dhe vlerës mesatare të reshjeve për Kosovë (892 mm). Sasia më e madhe e reshjeve bie në muajin nëntor 79 mm, kurse minimale në gusht vetëm 38 mm. Sasia më e madhe e reshjeve bie në muajt nëntor dhe maj. Në Prizren ndihen elementët e regjimit pluviometër miratime me sasi diçka më të madhe të reshjeve në pjesën e ftohtë të vitit X-III me afër 53% të shumës vjetore.

3.6.2 Erërat

Erërat me drejtimet e lëvizjes dhe shpejtësinë e tyre janë faktor i rëndësishëm në formimin e kushteve të jetës, por edhe në përcaktimin e ndikimeve mjedisore. Lokacioni i impiantit, karakterizohet kryesisht me erëra nga drejtimet siç janë e veriut (13,8 %), veri-lindja (36.2%), dhe perëndimi (31 %), ndërsa më së paku fryjnë erëra e lindjes (11 %), jugut (6 %) dhe jug-lindja (2 %).

3.7 Natyra dhe biodiversiteti

Aktivitetet primare ekonomike ku përfshihet bujqësia me degët e saja, janë veprimtari ekonomike që historikisht kanë dominuar në këtë komunë. Llojllojshmëria e monumenteve natyrore të karakterit botanik në Komunën e Prizrenit dhe peizazhet e shumëllojshme natyrore që janë të shpërndara në komunë konsiderohen si vlera natyrore të trashëgimisë. Zona totale e pyjeve si habitatet më të pasura është rreth 23,570 ha, ku sektori privat i ka rreth 3,897 ha dhe 12,170 ha janë pronë publike.

Bazuar nga të dhënat e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AKMM) respektivisht sipas Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN), PZHK- Prizren 2013-25, por edhe sipas observimeve në terren, në afërsi të lokacionit ku gjenden impiantet e cekura, nuk ka zona të mbrojtura. (AMMK-IKMN 2008, 2010).

3.8 Flora dhe vegjetacioni

Sipërfaqet bujqësore, si sipërfaqet të rëndësishme ekonomike paraqesin bazën të rëndësishme natyrore për Komunën e Prizrenit. Kushtet të volitshme klimatike, sidomos numri i madh i ditëve me diell gjatë sezonit veror si dhe ujitja me anë të pipave kanë dhënë efekte pozitive si për kulturat lavëtarë (specat, domate, patate, bostan, qepë etj.) ashtu edhe për kultivimin e pemëve. Sipërfaqet bujqësore përfshijnë një sipërfaqe prej 19.998 ha dhe sipërfaqet janë të mbjella me këto kultura: gruri, elbi, tërshëra, misri, peme dhe perime, etj.

Sipërfaqet më pjellore janë rrafshinat e Anadrinit duke filluar prej Krushës së Vogël, Piranë, e Zojz e Medvec, deri te Korisha në veri dhe veri perëndim të qytetit të Prizrenit, e gjerë në Poslisht, Vlashnje, Zhure e Vermicë në jug. Në këto toka më së shumti kultivohen perimet dhe pemët, ndërsa në pjesët tjera në sasi më të vogël kultivohen edhe drithërat tjera si grurë, misër etj. Nga pemë të ndryshme më së shumti kultivohen këto produkte: molla, dardha, kumbulla, pjeshka, arra, kajsia etj., ndërsa nga perimet që kultivohen më së shumti janë: specat, domate, patate, bostan, qepë, pjepër etj.

Livadhet përfshijnë një sipërfaqe të konsiderueshme të komune së Prizrenit, ndërsa kullosat në këtë komunë zënë një hapësirë edhe më të madhe se livadhet. Këto sipërfaqe kanë ndikim në zhvillimin dhe mbajtjen e ekuilibrit të ekosistemit. Sipërfaqet të përgjithshme të përfshira me pyje janë 55-60 % e sipërfaqes së territorit të Prizrenit. Sipërfaqet e pyjeve përbëhen

nga bingu, qarri, ahu, dushk, por ka edhe shkozë dhe frashër të zi. Ka sipërfaqe të tokave të zhveshura, të cilave në të ardhmen duhet ti kushtohet kujdes në pyllëzimin e sipërfaqeve të tilla. Me këto masa do të forcohet funksionimi i pyjeve në procesin e mbrojtjes së mjedisit (ambientit), në stabilitetin për formimin e kushteve klimatike që do të mundëson për rekreacion. Funksioni i pyjeve është mjaftë me rëndësi për mbajtjen e ekuilibrit biologjik-ekologjik të këtij territori.

Në kuadër të florës së pasur me afro 2500 lloje të bimëve veçohen 323 bimë endemike që këtë territor e bënë tunikat në Ballkan, ndoshta edhe në Europë. Llojet më të rëndësishme drunore janë endem reliktet rrobulli (*Pinus heldreichii*) dhe arneni (*Pinus peuce*), ndërsa vlerë të veçantë kanë 20 lloje të bimëve steno-endemike: barpezmi i Aleksandrit (*Achillea alexandris regis*), bornmulera e Dieckit (*Bornmullera dieckii*), cerasti i Sharrit (*Cerastium neoscardicum*), karafil i Sharrit (*Dianthus scardicus*); draba e korabit (*Draba korabensis*); potentila e Doerflerit (*Potentilla doerfleri*); krokusi i Sharrit (*Crocus scardicus*); bar peshku i Sharrit (*Verbascum scardicum*), kokëz e Shmukerit (*Silene schmuchi*), kë mashna e Kobilicës (*Hieraceum kobilicanum*), kë mashna e Lubotenit (*Hieraceum naegelianum* supss. *Lubotenicum*), rrushqyqe (*Sedum flexuosum*), etj.

Ndërsa sa i prekte operimi të impiantit në lokacionin e cekur, nuk do të ketë çrregullime të shumta në flore dhe biodiversitet dhe nuk do të ketë efekte negative në cilësinë e ajrit dhe ambientit për rreth nëse merren të gjitha masat e parapara në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis që është punuar si pas ligjeve të Rep. Kosovës.

3.9 Fauna

Në tërë territorin e komunës së Prizrenit rrjedh shumë lumenj si, Drini Bardhë, Lumëbardhi i Prizrenit, lumi Toplluha, si dhe shumë përrenj dhe përroska të cilët derdhen në këta lumenj që ka rëndësi të madhe ekonomike dhe në të gjenden numri i madh i llojeve të peshqve. Në Drinin e Bardhë ka më së shumti bërcak mustak, rapuli, marule, krap, ngjal dhe trofta e cila lajmërohet kohë pas kohe. Përafërsisht llojet e njëjtë të peshqve ndodhen edhe në lumenjtë tjerë të

Përpos peshqve ka edhe bretkosa, gaforre dhe gjarpinj të ujit. Ndërsa në ekonominë familjare kultivohen gjedhet, kuaj, dele, dhi, derra si dhe shpezë.

Në territorin e komunës së Prizrenit sidomos në zonën e maleve të parkut Kombëtar "SHARRI", janë prezentë edhe shtazët e egra siç janë: dhelpra, ujku, lepuri, derri i egër, ariu, dhi të egra, etj, po ashtu në këtë park ka edhe shumë fruta të egër si: Boronica, mjedra, gështenja, thana, molla dhe dardha të egra, etj. Po ashtu edhe një numër i madh i bimëve shëruese si dhe po ashtu edhe një numër i konsiderueshëm i llojeve të kërpudhave.

Shpezë në territorin e komunës së Prizrenit, që janë më të njohura janë këto: thëllëza, sorra, harabeli, pata e egër, korbi, bylbylat, pëllumbat, kumria (Gugutka), skifteri (gjeraqina), shqiponja, pulat e egra dhe lejleku gjatë stinës verore e posaçërisht përgjatë rrjedhjes së lumit Drini Bardhë.

Gjendja e tanishme e ekuilibrit biologjik-ekologjik të komunës së Prizrenti ka kushtet të përshtatshme për zhvillimin florës dhe faunës e cili do të do te vinte edhe me tepër në shprehje më rritjen e sipërfaqeve me pyje të llojeve të ndryshme të drunjte, rruajtjen e gjendjes ekzistuese të peshqve dhe begatimi i tyre, kjo vlen edhe për llojet të ndryshme të shpezëve dhe egërsirave të cilat i ka ky territor.

Si pas vizitave në terren zona ku është ndërtuar ky projekt është një zone e ndikuar nga faktori njeri, pasi që në afërsi të zonës operojnë një numër i konsiderueshëm i objekteve industriale dhe veprimtarive minerare.

3.10 Peizazhi

Peizazhi, paraqet një nga veçoritë e rëndësishme të cilat duhet trajtuar në kuadër të vlerësimit të ndikimeve në mjedis. Edhe pse si definicion, paraqet një tërësi të elementeve natyrore, me vlerë vizuale dhe relaksuese, që d.m.th. në kuptimin e ndotjes dhe emisioneve nuk paraqet efekte direkt në shëndet, megjithatë kjo duhet trajtuar dhe vlerësuar me kujdes.

Rajoni i Prizrenit ka një ndër peizazhet më të mira në Republikën e Kosovës, me vendin më të ulët më lartësi mbi detare në Kosovë që është rreth 275 metër mbi nivelin e detit e cila ndodhet në Vermicë, e cila ndodhe në jug-perëndim të qytetit të Prizrenit si dhe me vargmalet e Sharrit me lartësi mbi detare rreth 2500 metër mbi nivelin e detit, të cilat shtrihen nga lindja deri në jug të qytetit, prandaj kjo edhe bën që qyteti edhe rrethina e Prizrenit të ketë një peizazh shumë të mirë me bukuri të shumta natyrore. Këtu vlen të përmendët edhe Kalaja e Prizrenit dhe shumë monumente tjera historike që ndodhe në këtë qytet por edhe në rrethin.

Ndërsa, siç është përshkruar më lartë, lokacioni i projektit është një lokacion ku ka pas ndërhyrje të njeriut në aspektin e peizazhit dhe rrjedhimisht me ndërtimin e impiantit të ri do të shtohen objektet që janë të ndërtuar nga faktori njeri.

3.11 Karakteristika Gjeologjike të Rajonit të gjerë

Ndërtimi gjeologjik i zonë zë hulumtimit është i përbërë kryesisht me rërë dhe zhavorr në zonën e lokacionit dhe gëlqerorët të moshës së të kretakut të sipërm në zonë e hasit, formacioneve të pliocenit të cila përbëhen nga materialet argjilore dhe sedimentet aluviore. Në zonë më të gjerë të këtij rajoni janë të evidentura formacionet kryesore të ndërtimit gjeologjik siç janë serpentinitet dhe dibazë stralorët në rrethinën e Rahovecit.

Formacionet e kretakut të sipër (K_2)- Mbështetur në hulumtime e bëra më parë sedimentet e serisë së kretakut të sipërm është bazamenti i krijimeve gjeologjike. Këto formacione janë të zbuluar në pjesën perëndimore në pjesën e Zymit me sipërfaqe rreth 16 km². Këto formacione i përkasin gëlqerorëve shtresor të Pashtrikut të cila kanë shtrirje në drejtim të veriut me elemente strukturore gjenerale 170/25. Këto formacione janë të mbuluara nga sedimentet e pliocenit dhe kuaternarit në kudër të koridorit të ndarë të gëlqerorëve të Zymit dhe Landovicës. Mbështetur në faunën dhe fosilet e gjetura, këta gëlqerorë janë klasifikuar si formime të Kretakut të moshës së Turonianit.

Sedimentet e pliocenit (Pl_3) - Sedimentet e pliocenit kanë shtrirje të gjerë në këtë rajon. Mbështetur në hulumtimet e bëra, formacionet e pliocenit kanë shtrirje në drejtim Veri-Perëndim Jugë-Lindje, në sedimentet e regjionit të Prizrenit. Pas përmbajtjes së gëlqerorëve të Zymit në të gjithë territorin pranë lumit Drini i Bardhë shtrihen sedimentet e aluviale. Ndërtimi i sedimenteve të pliocenit përbëhen nga argjilat të cila shtrihen nga kuota 350-500 m.

Ndërtimi i kompleksit të sedimenteve të pliocenit përbëhen nga argjilat me rërë me ngjyrë të hirtet dhe të verdhë, rërë me kokërr trashë me ngjyrë të verdhë, zhavorr me ngjyrë të zezë dhe argjilë me rërë me ngjyrë të hirtet. Përbërësit kryesor të sedimenteve të pliocenit janë argjila me përbërje të rërës. Në regjionin e Landovicës në vitet më parë dhe në këtë periudhë, argjilat e këtij lokaliteti janë përdorë dhe përdorën si lëndë e parë për prodhimin e materialeve ndërtimore sikur që anë materialet e pjekura nga argjila. Shtresat me rërë kokërr trashë me ngjyrë të verdhë paraqiten në kuadër të ndërshtresave të serisë siç janë rërët argjilore e cila është e pjesë e serisë së shtresës së argjilës me rërë.

Mbështetur në hulumtimet e bëra më parë, është evidentuar fauna e cila paraqitet në shtresat argjilore me rërë, rërë me argjilë të përfaqësuara nga;

- ✓ *Dreissensia* sp
- ✓ *Viviparus*
- ✓ *Lithoglyphus fuscus* Ziegl
- ✓ *Dreissensia musteri* brus
- ✓ *Viviparus (Viviparus) conica* plav

Mbështetur në fosilet e përcaktuara, lloji i këtyre sedimenteve e kanë përcaktuar edhe moshën e cila është përcaktuar si kati lanvantian gjegjësisht masha e Pliocenit të sipërm. Karakteri i fosileve dhe shtresave të qymyrit të paraqitura në disa pjesë të serisë, tregojnë se formimi i këtyre shtresave argjilore i përkasin regjimit të mjediseve liqenore të ujërave të qeta dhe të ëmbla.

Sedimentet e kuaternarit (Q_3) - i përkasin aluvioneve të lumit Drini të Bardhë dhe teracave lumore të këtij lumi. Këto formacione janë të përbëra kryesisht nga zhavori, rëra dhe zhavori dhe suargjilat. Në hulumtimet e më parshme, është vërtetuar se sedimentet aluviale të

Drinit të Bardhë në këtë territor janë të përbëra nga zhavorret me kokrriza të vogla me pjesëmarrje me përqindje % të vogël të madhësive që kalojnë mbi 60 mm.

Trashësia e shtresave të zhavorrit, rërës pranë luginës së Lumit Drini i Bardhë nuk kalojnë mbi 5-7 m. Sedimentet aluviale të Drinit të Bardhë janë të shtrira në një gjatësi prej 5-7 km me një gjerësi 300-400 m. Sedimentet më të rëndësishme të përbërë nga rëra dhe zhavorri shtrihen në pjesën nga fshati Krajë, Piranë dhe Zymë. Pjesa më e vogël në të cilën e përbëjnë sedimentet aluviale të Drinit të Bardhë shtrihen në pjesën e majtë të Lumit ndërsa pjesa më e madhe shtrihen në pjesën e djathtë. Formacionet kuaternare të këtij territori janë sedimente shumë të klasifikuara të cilat kanë madhësi të fraksioneve 4-4 mm, të cilat kanë përbërje nga minerali kuarci, felshpatet të cilët sillen rreth 50-60 %, dhe anëtarë të tjerë të pa rëndësishëm. Figura 4 harta gjeologjike e zonës së Krajë, Piranës dhe Zymës.




Figura 5. Harta gjeologjike e lokacionit

3.12 Karakteristikat hidrologjike

Duke u bazuar në dokumentacionin ekzistues dhe hartografin detale hidrogeologjike të zonës, janë evidentuar të gjitha paraqitjet e ujit nga burimet ekzistuese dhe hapësirat e Huluntuara. Në bazë të këtyre të dhënave është bërë kartografimi gjeologjik dhe hidrogeologjik, është punuar harta hidrogeologjike, profilet hidrogeologjike të cilat karakterizojnë të gjitha detajet e burimit të ujit dhe kontaktet e formimeve të depozitimeve kuaternare dhe pliocenit gjegjësisht pjesët nëntokësore të burimeve ujore.

Bazuar në formacionet gjeologjike dhe veçorit e tyre litolo-stratigrafike, strukturore e tektonike, në zonën e Krajë, Piranës dhe Zymës janë dalluar tipet kryesore të akuferëve.

- Akujferi i përbërë nga formacionet aluviale të kuaternarit ndryshe quhen akujfer granular
- Akujferi i përbërë nga formacionet e Miaceni dhe Pliocenit ose akufer intergranular

Akujferi i përbërë nga formacionet aluviale të kuaternarit të përbëhet nga teracat e lumit të Drinit të Bardhë, me rërë dhe zhavorr arrijnë gjerësinë mbi 700 m, e cila varijon nga 5.0m deri në 10m, të thellësisë. Në drejtim të rrjedhjes së lumit Drini i Bardhë gjerësia e aluvioneve gradualisht zvogëlohet. Në bazamente e këtyre formacioneve gjenden argjilat, suargjilat.

Amplituda e luhatjes së nivelit të ujërave nëntokësor në këtë zonë varijon varësisht nga reshjet atmosferike 0.30-4.32 m dhe niveli i rrjedhjes së Lumit të Drini i Bardhe. Luhatja e regjimit të niveleve të ujërave nëntokësor varet nga përbërja granulmetrike e rërës dhe zhavorrit, reshjet atmosferike dhe nga morfologjia e terrenit.

Sipas studimeve më të hershme nga (IH, Jerosllav Çerni, 1983 Vilimonoviq 1973) rezulton se koeficienti i filtrimit të aluvioneve të lumit Drini i Bardhë në zonën Krajkut, Prianë, Krushës së Vogël luhatet nga 1.37×10^{-5} m/sec dhe prurja e luhatet nga intervali 5-10 l/sec ndërsa prurjet specifike në kufijt 3-7.5 l/s/m. Luhatja stinore e nivelit të ujërave nëntokësor luajnë rol, përveç sistemit të ushqimit për mesë reshjeve, edhe furnizimet ndihmëse anësore përgjatë rrjedhjeve nga tarracat lumore të Drinit të Bardhë. Lidhja e mirë hidraulike e ujërave nëntokësor me ujërat sipërfaqësor ndikon jo vetëm në ruajtjen e bilancit ujqor në komplekset aluviale, nikohsisht ato ndikojnë edhe në ushqimin e vazhdueshëm të ujërave nëntokësor të zonave akujfere granulare të zonës së Krajkut, Piranës dhe Krushës së Vogël. Akuferët në zonë e Krajkur dhe Piranës i takon tipit granular që lidhen me depozitimet e tipit poroz dhe kryesisht përbejnë ujërat të tipit freatik ushqehen me lehtë nga Lumi Drini i Bardhë me zonat aluvione siç është zona akujfere Piranës, Krajkut dhe Zymit. Litologjia e hapjes së puseve i parket materialeve të përbërë nga humusi me trashësi nga 0.3 deri në 1.0 m, shtresa tjetër janë të përbërë nga rëra dhe zhavorri. Rëra dhe zhavorri i këtij terreni ka peshë vëllimore nga 1880 deri në 1900 kg/ m³ ndërsa pesha specifike arrijnë 2700 kg/ m³. Materiali i përbërë nga rëra dhe zhavorri janë kolektorët kryesor të ujërave nëntokësor.

Këto ujëra karakterizohen nga këto veti kryesore;

- ✓ Janë ujëra pa presion të lirë (niveli i lirë)
- ✓ Luhatja e nivelit të ujërave varet kryesisht nga reshjet atmosferike
- ✓ Regjimi i tyre varet nga pozita gjeografike, klimatike, relievi, rrjeti hidrografik, mbulesa e tokës.
- ✓ Shtrirja e horizontit ujëmbajtës përputhet me zonën e ushqimit
- ✓ Në përgjithsi kanë lidhje hidraulike me ujrat e lumenjve
- ✓ Ushqehen nga lumi dhe ushqejnë lumin me ujë, kjo ndodhë gjatë stinës së thatë dhe stinëve me reshje.

Ushqimi i ujërave nëntokësor në këtë tip akuferi në zonë e Krushës së Vogël, Piranës, Krajës vjen si rezultat i reshjeve atmosferike dhe nga drenimi i ujërave nga ujërrjedhat në basenet mollasike.




Figura 6. Harta hidrologjike e zonës

3.13 Trashëgimia natyrore në Prizren

Rezervatet natyrore janë hapësirat origjinale të natyrës me forma karakteristike të bimëve, kafshëve si pjesë integrale e ekosistemeve të dizajnuara kryesisht për ruajtjen e stokeve gjenetike. Rezervatet natyrore janë ruajtur in situ (në vend) me nën klasifikimin e bimëve, kafshëve ose rezervateve speciale. Në Kosovë ndodhen 75 zona të mbrojtura natyrore me 46.437 ha (4.25% e territorit të Kosovës). Në Prizren ndodhen tre rezervate natyrore: Maja e Arnetit, Oshlaku dhe Pisha e madhe me përbërje të pastër të munikës-arnenit (*Pinus Heldreichi*); Hapësira më e madhe e mbrojtur është Parku Nacional “Malet e Sharrit” që ndodhet në Komunën e Prizrenit.

Malet e Sharrit ndodhen në Kosovë dhe Maqedoni dhe ka një sipërfaqe prej 1600 km². Pjesa veriore e Maleve të Sharrit i takon Kosovës me një sipërfaqe prej 1100 km².

Në vitin 1986, nga Kuvendi i Kosovës, Parku Nacional i Maleve të Sharrit ka fituar statusin e regjistrimit si trashëgimi natyrore, i klasifikuar si Park natyror.

Parku Nacional ka planin e tij zhvillimor të përpiluar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në pajtim me rregullat ndërkombëtare për parqet nacionale. Me karakteristikat e saja të pasura natyrore, si sipërfaqja topografike, klima dhe vetitë hidrologjike si dhe biodiversiteti i florës dhe faunës, parku nacional është shpallur si qendër e hulumtimit shkencor dhe edukativ në shkencat natyrore dhe zhvillimin ekonomik rural dhe ekoturizmin.

Por parku është në rrezik të madh të nga ndotja dhe degradimi i mjedisit si rezultat i përdorimit joracional të burimeve natyrore, si dhe prerja ilegale e pyjeve dhe niveli i lartë i erozionit (Plani Hapësinor – Parku Nacional “Mali Sharr”). Parku Nacional “Malet e Sharrit” dallojnë me vlera botanike, shtazore, ekologjike, turistike, rekreative, sportive, edukative dhe kulturore. Parku është aq i pasur me biodiversitet jo vetëm në Kosovë por edhe në regjionin e Gadishullit Ballkanik, dhe përfaqëson një thesar të llojeve bimore ku disa prej tyre janë endemike, të rralla ose të rrezikuara nga shfarosja.

Në Parkun Nacional “Malet e Sharrit” ndodhen 4 rezervate të mbrojtura natyrore. Tre prej tyre ndodhen në Komunën e Prizrenit si rezervat natyror si: Maja e Arnetit, Oshlaku dhe Pisha e madhe. I katërti është Rusenica në e cila ndodhet në komunën e Therandës ku jeton rrëqebulli i Ballkanit.

3.14 Asetet e Trashëgimisë Kulturore

Qyteti ka më së shumti monumente dhe lokacione që përfaqësojnë sfondin historik të territorit të saj. Enti për mbrojtjen e monumenteve ka inventarizuar gjithsej 291 monumente kulturore në Komunë e Prizrenit. Qyteti ka më së shumti monumente dhe lokacione që përfaqësojnë sfondin historik të territorit të saj. Kalaja e Prizrenit është lokacioni më i rëndësishëm arkeologjik në Komunë dhe përcakton karakteristikat monumentale të Prizrenit sidomos nga shekujt 11-14.

Në fshatin Romajë dhe Kushnin ndodhen grumbuj gurësh që datojnë nga periudha parahistorike. Edhe në fshatin Korishë, Nashec dhe Vlashnje gjenden mbetjet arkeologjike të fortifikatave. Numri i përgjithshëm i lokacioneve arkeologjike në Prizren është 24 dhe ato paraqesin shembujt e monumenteve antike dhe trashëgimisë arkeologjike që datojnë nga shekulli 1 deri në shekullin 14 të erës sonë.

Bazuar nga vrojtimet në terren dhe nga Plani Zhvillimor i Komunës së Prizrenit 2013-2025, në afërsi të zonës së impianti nuk kemi ndonjë monument të trashëgimisë natyrore dhe kulturorë.

4 PROCESIT TEKNOLOGJIK I PRODHIMIT DHE OBJEKTET

4.1 Objektet – pajimet

Objektet-Kompania Rizam Holding për të shtruar aktivitetin në mënyrë sa ma normale u desh patjetër të investon në objekte për ti vendosur pajisjet e prodhimit (fabrikën e prodhimit).

Objekti Kryesor – Objekti Kryesor është i ndërtuar në një hapësire të rrafshët sipas standardeve të ndërtimit.

Objekti Kryesor ku është e vendosur fabrika e prodhimit është i përberë prej dy pjesëve:

a. Pjesa e parë e objektit:

- Gjatësia e objektit të parë është 150 m
- Gjerësia e objektit të parë është 25 m
- Lartësia e objektit të parë është 8 m

b. Pjesa e dytë e objektit:

- Gjatësia e objektit të parë është 140 m
- Gjerësia e objektit të parë është 25 m
- Lartësia e objektit të parë është 8 m

c. Pjesa e tret e objektit:

- Gjatësia e objektit të parë është 40 m
- Gjerësia e objektit të parë është 15.70 m
- Lartësia e objektit të parë është 8 m

Objekti përbëhet prej 4 hyrjeve dhe daljeve, ku hyrja dhe dalja kryesore shërben për hyrjet dhe daljet e punëtorëve dhe nxjerrjen e prodhimit të gatshëm jashtë objektit, objekti disponon edhe hyrjet dhe daljet alternative në rast nevojë.

4.1 Përshkrimi i procesit teknologjik

Prodhimet e ndryshme argjilore përgatiten me procese teknologjike mjaft të ngjashme, prandaj është me interes t'i referohemi një diagrami të përgjithshëm përpunimi, në të cilin përfshihen këto etapa kryesore të përpunimit:

- a) punimet në terren;
- b) përpunimi mekanik (copëtimi, thërrmimi) i argjilave;
- c) formimi i brumi;
- d) tharja dhe pjekja;
- a) Punimet në terre;

4.1.1 Punimet në terren

Punimet në terren përfshijnë: gërmimin, staxhionimin natyrorë dhe transportimin e argjilës në fabrikë. Argjila, e gërmuar me mekanizma të ndryshme, i nënshtrohet një trajtimi paraprak në përmjet veprimit të vazhdueshëm të agentëve atmosferike. Veprimi i alternuar i ngrirjes dhe i shkrirjes dimërore në ajër të hapur shkatërron strukturën natyrore të argjilave, sjell shpërbërjen në grimca elementare të saj etj., gjë që çon në rritjen e plasticitetit e, për pasojë, dhe vetitë e formimit të masës së argjilës.

Me qëllim që lënda e parë të jetë sa më përfaqësuese e vendburimit, rekomandohet që gërmimi në pirgun e formuar të bëhet gjatë trashësisë së shtresave me anë të ekskavatorit me kova, të ekskavatorit me lopatë të drejtë etj.



Figura 7. Marrja e argjilës ne terren.

4.1.2 Përpunimi mekanik i argjilave

Ky proces realizohet me anën e makinave të përpunimit të argjilave dhe ka për qëllim copëtimin, thërrmimin dhe homogjenizimin e saj. Në bazë të këtij procesi janë cilindrat e laminimit, d.m.th. çifte cilindrash boshllëku në mes të cilëve dora-dorës ngushtohet. Zakonisht, vendosen një deri në katër çifte cilindrash, në varësi të fortësisë së argjilës dhe të sasisë së gurëve që përmban etj. Argjila e copëtuar në dezintegrator në kokrriza më përmasa 30 mm thërrmohet në çiftin e parë në ndarje 10 mm, ndërsa në çiftin e dytë nga 10 deri në 2.5 mm. Masa e argjilës, e përgatitur më lart, depozitohet në mjedise të veçanta të mbuluara për t'u

staxhionuar në mënyrë artificial për një periudhë rreth 8-10 ditë. Gjatë kësaj kohe masa është në qetësi ose që “fle”, realizohet stabiliteti mikrogjallesave dhe mesatarizimi i plotë i lagështisë. Përpara formimit, argjila i nënshtrohet një thërmimi të mëtëjshëm deri në përmasa kokrrizash 1mm prodhimi me cilësi të lartë i materialeve qeramike varet nga cilësia e përpunimit të lëndës së parë.

4.1.3 Formimi i brumit

Formimi i brumit të prodhimeve argjilore realizohet në katër mënyra: plastike, gjysmë të thatë, të thatë dhe me derdhje. Zgjedhja e llojit të mënyrës së formimit të brumit të argjilës varet nga dy faktorë: a) nga lloji i materialit që do të prodhohet, dhe b) nga karakteristikat fiziko-kimike të lëndës së parë argjilore që do të përdoret, sepse jo të gjitha argjilat janë të përshtatshme për të prodhuar të gjitha llojet e prodhimeve argjilore. Mënyra plastike e formimit të brumit është e përhapur më shumë, meqenëse i përshtatet shumicës së argjilave, me përjashtim të argjilave të forta dhe me plasticitet të vogël. Gjithashtu, ky proces është me levërdi edhe për faktin shumica e argjilave, pas gërmimit, përmbajnë lagështi në pjesën më të madhe të kohës. Para se të përgatitet masa me lagështinë përfundimtare, duhet të bëhet thërmimi në kokrriza deri në 1 mm. Pas kalimit të argjilës nëpër çiftin e fundit të cilindrave, për të homogjenizuar masën e argjilës me lagështi 18- 20%, vendoset një përzierës.

Për formimin e masës shërben presa që përbëhet nga një cilindër horizontal metalik, brenda të cilit rrotullohet një bosht helikoidal. Presat mund të jenë me ose pa vakum (Figura 3.9a). Argjila futet në presë me anën e një hinke, përziehet dhe shtyhet përpara drejt daljes së presës me anë të helikës së boshtit. Në seksionin e daljes masa e argjilës ngjeshet, uniformizohet presioni dhe shpejtësia. Në dritaren e daljes së brumit nga presa vendosen forma të ndryshme, në varësi të llojit të prodhimeve që kërkohen të realizohen. Kështu, në rastin kur prodhohen tulla të plota, ajo është në formën e katërkëndëshit kënddrejtë. Për të formuar tulla me faqe të holla dhe me boshllëqe, në kokën e presës vendoset një pajisje veçantë që krijon format edëshiruara. Masa e argjilës del nga presa në formën e një shiriti të vazhdueshëm dhe me anën e prerësit dinamik e static ajo pritët në copa me gjatësinë e kërkuar. Mënyra e formimit gjysmë e thatë prodhimet prej argjile formohen duke presuar në trusni 15-40 MPa masën e argjilës që përmbanë 8-10% lagështi. Për formimin gjysmë të thatë, zakonisht, përdoren argjilat me lagështi natyrore jo 10 të madhe, që nuk kërkojnë tharje para bluarjes së tyre. Përparësia e përdorimit të metodës së formimit gjysmë të thatë në krahasim me atë që formimit plastik është zvogëlimi i shpenzimeve të energjisë gjatë pjekjes. Mënyra e formimit të thatë teknologjia është

e ngjashme me mënyrën e formimit gjysmë të thatë, me ndryshimin se në këtë rast përqindja e sasisë së ujit është më e ulët, rreth 3- 4% kundrejt masës së thatë, prandaj rekomandohet përdorimi i lëndëve argjilore që në gjendje natyrore nuk përmbajnë ujë. Procesi teknologjik i përgatitjes së prodhimeve prej argjile të pjekur me këtë mënyrë mund të përmbledhet në këto operacione kryesore:

- Copëtimi i argjilave në dezintegrator;
- Tharja e argjilave në cilindrat tharës;
- Bluarja e argjilës së thatë;
- Fraksionimi dhe shmangia e kokrrizave me përmasa të mëdha;
- Dhënia e lagështisë së nevojshme për presimin e masës (3-4%) dhe
- Presimi, tharja dhe pjekja.



Figura 8, Presa për formimin e prodhimeve argjilore.

4.1.4 Tharja

Për arsye se materiali natyror i argjilës ka lagështi të madhe të ujit atëherë duhet tharë materialin e lëndës së parë deri sa të mbetet lagështia optimale për prodhimin e brumit. Gjysmë prodhimet prej argjile, të përgatitura në mënyrat e formimit me brumë plastik ose gjysmë të

thata, thahen deri në largimin e lagështisë së tepërt. Tharja quhet e përfunduar, kur lagështia që përmban prodhimi i formuar nuk kalon 5%. Ky operacion është një veprim delikat, për të shmangur ngritjen e tensioneve të brendshme, ndryshimin jo të njëtrajtshëm të vëllimit, shformimin e prodhimeve etj. Tharja duhet të realizohet ngadalë, me qëllim që shpejtësia e avullimit të ujit të mos kalojë shpejtësinë e përhapjes së ujit nga brendësia e prodhimit në periferi të tij. Avullimi i ujit ndodh në dy kohë, në fillim largohet uji i vendosur në sipërfaqe të prodhimit dhe më vonë ai që gjendet në thellësi të tij. Është provuar se tërheqja (tkurrja nga tharja) ndodh në periudhën e parë e cila përbënë edhe fazën më delikate, d.m.th. fazën në të cilën prodhimi humb sasinë më të madhe të ujit. Prandaj, kjo fazë duhet të zgjatet sa më shumë që të jetë e mundur, në mënyrë që të shkaktojë përhapjen e ngadaltë të ujit nga zemra e materialit në periferi duke shmangur tkurrjen e prodhimit para se uji të kalojë nga thellësia në sipërfaqe. Tharja kryhet në dhomat ose tunelet e tharjes. Tunelet tharës punojnë sipas parimit të rrymave të kundërta. Gjysme prodhimet, të vendosura mbi vagonë, lëvizin në tunel në drejtim të kundërt me rrymën e ajrit të ngrohtë, ndërsa dhomat e tharjes janë sisteme të tilla që çdo dhomë ngrohet pavarësisht nga tjetra. Tharja bëhet me ajër të ngrohtë ose me gaze të nxehta që dalin nga furra; këto të fundit përdoren vetëm në ato raste, kur përdoren lëndë djegëse që nuk përmbajnë squfur. Në dhomat e tharjes vendosen ventilator për të shpërndarë njëtrajtshmërisht ajrin e nxehtë. Pas tharjes, prodhimet prej argjile që kanë jo më shumë se 5% lagështi, futen në furrë për t'u pjekur.

4.1.5 Pjekja

Është veprimi që ka për qëllim të realizojë një ndryshim rrënjësor të karakteristikave të produktit të papjekur, d.m.th. të japë një prodhim me rezistencë mekanike më të lartë në shtypje, me pamje të hijshme, të qëndrueshme ndaj agentëve kimikë dhe ndaj ngacmimeve fizike. Pra, pjekja përbën stadin më të rëndësishëm të prodhimit dhe kolaudon veprimet komplekse të realizuara më parë. Ajo realizon ngrohjen e gjysmë prodhimeve të thara dhe ftohjen e tyre sipas një program të paracaktuar. Pjekja kryhet në temperaturë 870-950 °C, në furrat kontinuale, ku bëjnë pjesë furrat e tipit Hoffman dhe furrat tunel. Këto të fundit kanë përparësi, sepse lejojnë mekanizimin dhe automatizimin e prodhimit dhe kanë rendiment të lartë. Në kohën e sotme, në rikonstruktionet e fabrikave të vjetra ose në ngritjen e atyre të reja preferohen kryesisht këto tipe të furrave.



Figura 9. Furra për pjekjen e produkteve te argjilës.

Kapaciteti i prodhimit është 18,000,000 milion copa blloka dhe produktet tjera qe dalin nga argjila, ndërsa kapaciteti i realizuar pritet te jete 14,500,000.

4.1 Paisjet e Prodhimit

Karakteristikat dhe kapaciteti i presës

Pjesa e lartë e PRESEËS, përbehet prej MISHERIT, Misheri prej lopatave dhe dy Kermillave, qëllimi është bartja e dheut deri të komorja e Vakumit.




Figura 10. a) presa dhe b) hinka e presës.

Pjesa e Vakumit (fig 11) - ka për qëllim thithjen e ajrit prej dheut, Pjesa e Vakumit përbehet prej brisqeve dhe llopaticeve, llopatiket e vogla që ndihmojnë në bluarjen e dheut, pastaj pas bluarjes se dheut bëhet transporti i dheut tek kërmilli i madh.



Figura 11. Komora e ajrit(Vakumi i dheut).

Kërmilli i madh (fig 12) -qëllimi i kërmillit është ngjeshja e dheut, prerja dhe dhënia e dimensioneve formës se bllokut dhe produkteve tjera.



Figura 12. Presa (Kërmilli i Madh)

Presa për behët prej shiritit 1 m, që bartë kallëpin e prodhimit deri te Teli i prerjes se bllokut, janë paraqitur ne figurën 13.




Figura 13. a) Presa (Kallëpi i Prodhimit) dhe b) Teli (Tavolina e Prerjes).




Figura 14. a) pulti komandues i presës kaldaja dhe b) rrotulluesit.

Matinat transportuese te bollkave rrotulluesit –qëllimi është transporti deri tek shiritat dhe llatat, figura 14 foto b.

Elevatori 1(Prodhimi i Lagur) – qëllimi i Elevatorit është bartja 10 rendeve me blloka (1 rende ka 7 cope blloka) deri tek Lladereni, prej Lladerenit deri në Vagon të tersës.

Elevatori 2-(prodhimit i terur)-Qëllimi është transporti i bllokave prej Laderneit në Elevator ku barten në shirita zingjiror, figura 15 foto a).




Figura 15. a) elevatori –pjesa e jashtme dhe b) pulti komandues i rrotullueses, elevatorit dhe laderenit.

Ladereni 1-(prodhim i terur) - Qëllimi është transporti i bllokave prej Vagonit në Laderen dhe Laderenit në Elavator.

Ladereni 2-(prodhim i lagur) - Qëllimi është transporti prej Laderenit në Vagon.

Abrahomer (prodhimi i terur) - Qëllimi është bartaj e transportit të prodhimit të terur dhe dergimi deri tek zingjiret.

Zingjiret (prodhimet e terur) - Qëllimi i zingjirave është bartja e prodhimeve deri tek Grupi Shiber. Ekzistojnë 6 copa zngjire, kapaciteti i bartjes është 28 copa.

Grupi Shiberi - Qëllimi i grupit shiber është bartja e prodhimeve deri tek Umzecgrajfer dhe Zecgrajferi.




Figura 16. a) FIBER BANI – (Pjesa transportuese) dhe b) Bnari 1.

Umzecgrajfer dhe Zecgrajferi-Qëllimi është bartja e prodhimit deri tek Vagonat e furrës, figura 15/a.

Binari 1- qëllimi është riparimi i vagonëve figura 15/b.

Binari 3- qëllimi është magazinimi i vagonave me prodhim të terurë dhe pjekur.

Binari 4- qëllimi është bartja e prodhimeve në sipërfaqen e FURRËS .

Binari 5- qëllimi është kthimi i vagonva të zbrazur pas shkarkimit, që i bartë në kollosekun nr.2.

litari 6-qëllimi është bartaje prodhimve nga FURRA në Shkarkim.

Sajlla e Tërheqjes-qëllimi është bartja e vagonave deri tek shofer bina.

Shofer Bina 1-qëllimi është bartja e vagonave deri në hyrjes të furrës.

Klipi -qëllimi është transporti i vagonave brenda në furrë.

Shofer Bina 2-qëllimi është bartja prodhimeve nga dalja e furrës deri në shkarkim




Figura 17. a) kolloseku dhe b) shiperbina (në hymje të furrës).

4.2 Parimi i punës

Fillimisht merret dheu (lënda e parë), nga bunkerat (bunkeri 1 ose bunkeri 2), ku argjila ka lagështinë deri në 20 %, kjo konstatohet nga analizat e bëra nga udhëheqësi i laboratorit paraprakisht.

Fillimisht si aktivitet behët homogjenizimi i prodhimit, shtohet lagështia e nevojshme sipas nevojës në mënyre automatike, kërkesa praktike për sasi të ujit të prodhimi 22-25 % lagështi, në mungesë të kësaj lagështie, PRESA I shtonë në mënyre automatike për të arritur këtë standard. Qëllimi i presës është dhënja e formës së bllokut.

Aktiviteti i dytë behët transporti i argjilës me shiritat transportues deri në PRESË, për këtë transport janë të angazhuar dy shirita transportues, shiritat transportues arxhilen e bartin deri tek HINKA e PRESËS, pastaj i shtohet uji dhe behët përzërja e arxhilës dhe i largohet thithet ajri pastaj zhvillohet aktiviteti i tretë.

Aktivitetet tjetër është BARTJA dhe PRESIMI, behët nëpërmjet kermive pra behët ngjeshja dhe FORMSIMI, formësimi behet sipas dimensioneve të kallëpit, pastaj jepen dimensionet e gjatësisë nga prerësi në mënyre automatike, pastaj pas marrjes së formës së prodhimit, nëpërmjet shiritit transportohet deri të rrotulluesit, ku behet edhe kontrollimi i prodhimit pra defekteve eventuale si qarja, ndryshimi i dimensioneve, jo formësimi i mirë i prodhimit, pastaj behët ndarjen dy nga dy të prodhimit, prodhimi bartet deri tek listelat, të cilat nëpërmjet shiritit transportues ngarkohen në vagonat e tersës.




Figura 18. a) presa dhe b) pulti komandues i presës.

4.3 Tharja - terrtorja

Karakteristikat e Uzinës janë:

Kapaciteti ditor i tharjes 450 ton

Kapaciteti i tharjes në moment 22,950 ton

Parimi i Punës-Terrtorës Ana e lagësht e Terrtorës;

Ana e Tharë e Terrtorës;

Ngarkimi i Vagonave të Terrtorës;

Tharja;

Shkarkimi i Vagonave të Terrtorës;

Trasporti i Vagonave të Terrtorës;

Trasporti i Listelave;

4.4 Kontrollimet

TERSJA (THARJA)-, Vagonat me prodhime hyjnë në TERËSE, ku qëndrojnë se paku 24 orë, temperaturat në tërse janë në hyrje -20-25 gr. celcius, pastaj temperaturat rriten gradualisht deri në 80 gr.celcius. Parimi i punës së TERRTORËS është tharja e prodhimit pra eliminimi i lagështisë deri në standardin e lejuar.

Temperatura për tharjen e prodhimeve merren nga Furra, pra këtu kem të bëjë me një sistem të harmonizuar , PRA ajri i cili në FURRË ka për qëllim ftohjen e prodhimit i njëjti bartët në TERËSE për tharjen e prodhimit nëpërmjet ventilatorave.

Teprica e ajrit të nxehet nga FURRA në TERSE ,bartet nëpërmjet një gypi të madh,ku pastaj ajri shpërndahet në miksera, për të arritur temperaturën e nevojshme

në TERRTORE, janë të angazhaur mbi 50 miksera (ventilatora) të TERËSES. Pastaj dy ventilatora ABLUFT bëjnë tërheqjen e ajrit të lagësht nga TERSJA dhe të njëjtin e bartin në atmosfer.

Kapaciteti i TERSËS: Në TERSE hyjnë 240 vagona, ku 1 vagon ka kapacitetin për:

Blloka: 1 vagon ka kapacitetin copë /bllokave; pra 240 vagonax 290 cope=69,600 cope /blloka.

Shkarkimi i vagonëve të TERSËS - Pas qëndrimi 24 orë në Terse te prodhimit, bëhet shkarkimi në mënyrë automatike nga ROBOTI FANUC , pra prodhimi kalon nga vagonat e TERSES , në vagonat e FURRËS.

Transporti i vagonave -TERSES -Pastaj Vagonat e TERSES, pas shkarkimit të prodhimit në vagonat e FURRËS ,shkojmë në mënyrë automatike për ngarkim në prodhim të lagësht (Fillim I procesit në Terse -CIKEL AUTOMATIK).

Transporti i Listellave -Sikurse edhe trasnporti i vagonave rregullohet në mënyrë automatike nga ROBOTI FANUC, pra nga shiritat dhe cilindrat bëhet bartja deri te presa për ngarkimin e prodhimeve të lagështa për vagona në hyrje të TERSES .

Kontrollimet- Kontrollimet e prodhimeve që dalin nga TERSJA, bëhen nga punëtori i cili punon tek ROBOTI FANUC,ky punëtor bllokat me NEN- KONFORMITET(qarja, thyerja, dimensionet e gjatësisë) i eliminon këto prodhime.

I njëjti punëtor mban shenime për SHKARKIMIN e vagonave të TERSËS dhe NGARKIMIN e vagonave të FURRËS.

4.5 Transporti në tersë

Brenda në TERSE janë 8 kollosek 2 Shofer Bina dhe 1 kollosek kthyes. Secili Kollosek ndahet me sistem me gypa.

FURRA PJEKJA

Parimi i punës - FURRA Ngarkimi i vagonave të -Furrës;

Transporti i vagonave të -Furrës; Paradhoma;

Riqarkullimi; Parangrohja;

Pjekja -Zona e pjekjes; Ftohja e shpejtë ;

Ftohja e prodhimit të pjekur; Presionet në Furrë;

Gazrat;

Ftohja e Tavanit;

Ftohja ndër vagonat e furrës; Shkarkimi i vagonave të furrës.

4.6 Pjekja - FURRA

- Karakteristikat e Uzinës
- Kapaciteti ditor i pjekjës (tolerimi +/-10%) 450 ton
- temperaturat e Pjekjës deri 950 grad celcius
- Dimensionet e furrës 125X4.60X2 m
- Gjatësia e përgjithshme 125 m
- Numri i vagonave në furrë (45 vagona)
- Numri i vagonave te parahymja 1




Figura 19. a) hyrja e furrës b) distributoret e ajrit.

Parimi i punës - FURRA

Qëllimi kryesor i furrës është pjekja e prodhimit, temperaturat fillojnë prej 80 gr.celcius në hyrja deri në 860 gr.celcius, varësishtë nga prodhimet. Prodhimet në FURRE QENDROJNE 24 ore.

b



Figura 20. a) Ventilatorët e furrës (riciklimi i ajrit) dhe b) pulti komandues.

Ngarkimi i Vagonave –Ngarkimi i vagonave me prodhime bëhet në mënyre automatike nga ROBOTI FANUC , prej vagonave të TERSËS ne vagonat e FURRËS.

Numri aktiv i vagonave të furrës është mbi 100, ndërsa 1 vagonë ka kapacitet 1600 copë blloka.

Transporti i Vagonave të furrës-Transporti i vagonave të furrës bëhet nëpërmjet një sajle e cila në mënyre automatike behën tërheqjen dhe i dërgon vagonat një nga një deri të shipërbina e cila pastaj i qonë në hyrje të furrës.

Paradhoma- Vagoni me prodhime të gatshëm fillimisht hynë në paradhomë ,koha e përafërt e qëndrimit të vagonit në paradhomë është nga 30-40 minuta.

Temperaturat në Paradhomë sillen nga 30 gr.celcius deri 60 gr.celcius. Ne Paradhomë bëhet para-përgaditja e prodhimit deri në temperature 30-60gr.celcius, kjo shërben për qëndrueshmerin e produkteve nga temperatura më të larta .

Riqarkullimi-Riqarkullimi mundëson ruajtjen e temperaturës konstante gjatë hapjes dhe mbylljes së derës në të cilën temperaturat luhaten gjatë hapjes së derës.

Te zona e Riqarkullimit ka kapacitetin 3-4 vagonave,vagonat ne këtë zonë qëndrojnë 2-3 orë.

Para ngrohja- Në zonën e para ngrohjes fillon rritja e temperaturave për përgatitjen e prodhimeve për ti bërë ballë temperaturave më të larta. Temperaturat në zonën e para ngrohjes sillen prej 300-600 gr.celcius.

Qëndrimi i prodhimit në zonën e para ngrohjes zgjatë 4-5 ore dhe prodhimi arrinë temperaturën e volitshme për pjekje.

Zona e Para ngrohjes ka kapacitetin 4-5 vagonave.

Pjekja –Zona e pjekjes; Në zonën e pjekjes temperaturat sillën prej 600-900 gr.celcius.

Qëndrimi i prodhimit në zonën e pjekjes zgjatë 5-6 ore dhe prodhimi arrinë pjekjen e nevojshme

Zona e Pjekjes ka kapacitetin e 7 -8 vagonave.

Ftohja e shpejtë ;Pas pjekjes së prodhimit fillon ftohja e shpejtë, qëllimi i kësaj ftohje të shpejtë është për të bërë qëndrueshmërinë, fortësinë e prodhimit.

Temperaturat në këtë zonë sillen deri në 700 gr.celcius, kapaciteti në këtë zonë është 2 vagona dhe prodhimet qëndrojnë 1 deri 2 orë.

Ftohja e prodhimit të pjekur- Qëllimi i kësaj ftohje është që prodhimet në mënyre graduale të ulin temperaturën në nivele të kërkuar deri në 60 gr.celcius.

Zgjatja e prodhimeve në këtë zonë ,është prej 8 – 9 oreve, pastaj prodhimet marrin temperaturën e nevojshme.

Presionet në Furrë- Në këtë zonë behët orientimi i ajrit të nxehtë, varësisht nga kërkesat e zonave për mbarëvajtjen e temperaturave. Gazrat –Në këtë fazë behët ndarja e gazrave , ku ajri i nxehtë shkon për TERSE , ndërsa tymi shkon në filtra ku pastrohen gazrat pastaj shkon në oxhak,ky proces ndodh në harmoni të përcjelljes së parametrave të furrës.

Ftohja e Tavanit- Për ti përballuar temp. shumë të larta ,ftohja e tavanit bëhet nëprmejt vrimave nga të cilave qarkullon ajri i freskët.

Ftohja ndër vagonat e furrës- Ftohja e vagonave behët nëpërmes ventilatoreve të cilët vazhdimisht fryjnë ajër të freskët dhe ulin temp. në nivelin e duhur.

Shkarkimi i vagonave të furrës-Pas daljes së vagonave nga furra, shiperbina në dalje të furrës i dërgon në operonin numër 4 nga ku fillon procesi i paletimit të prodhimit të gatshëm nga ROBOTI FANUC.

4.7 Lëndët e para materialet ndihmëse dhe të tjera

Lëndët e para – Argjila është lende e pare dhe baze për prodhimin e materialeve argjilore. Prej argjilës ndërtohen tullat, blloqet, tjegullat dhe produkte të tjera ndërtimore.

Kompania ka zonën mineral mbajtëse të kësaj lëndë për të cilën ka licencë të shfrytëzimit.

Lëndët ndihmëse- Uji - Sasia e shfrytëzimit të ujit: Për proces të prodhimit m^3 /vit, Për nevoja jo prodhuese (kuzhinë e të ngjashme, pije, pastrim higjienë) m^3 /vit dhe prej nga e merr ujin psh nga ujësjellësi, pusët vetanake- sa është sasia e hargjuar e ujit nga pusët dhe sa nga ujësjellësi.

Për nevojat e fabrikës (prodhimit) përdoret uji nga pusi vetanak dhe shpenzimi mujor është $3600m^3$ ose $43,200m^3$ në vit.

Ndërsa uji për pije, kuzhine etj. përdoret nga hidrosistemi Radoniqi. Konsumi mesatar mujor është rreth $400m^3$.

Rryma elektrike përdoret për funksionimin e elektromotorëve të makinave, tabelave komanduese (pulteve) dhe pajisjeve tjera elektronike. Harxhimi mujor mesatar është $280,000$ kWh ose $3,360,000$ kWh në vit.

Mazuti përdoret gjatë procesit të prodhimit në fazën e pjekjes së gjysmën produkteve dhe hargjimi sillet rreth 20-30% të lendeve djegës të hargjuara në vit.

Kapaciteti i dy rezervuareve të mazutit është $47,000$ litra dhe $53,000$ litra

Petrolkoksi përdoret për pjekjen e bllokave në furrë dhe disponojmë me 2 rezervuar me kapacitet $2 \times 63,500kg$ ose $2 \times 128,000$ Kg petrolkoks.

Sasia mesatare e hargjuar e petrol koksit është $5,400$ ton në vit. Për këtë arsye shtetet e zhvilluara në bote në 30 vitet e fundit janë duke kërkuar zgjidhje për ruajtjen e resurseve energjetike dhe vendosjen e teknologjive “miqësore” për ambientin jetësor. Zgjidhja më e mirë është gjetur në përdorimin e mbeturinave si energji alternative.

Në anën tjetër mbeturinat si prodhim i aktiviteteve njerëzore dhe ndikimi i tyre në ambientin jetësor paraqesin problemin më të madh në bote. Përpunimi i tyre dhe përdorimi do të thotë:

- Zvogëlimin e hapësirave për deponimin e tyre
- Zvogëlimin e rreziqeve nga ndotja e ujërave nëntokësore dhe tokës
- Zvogëlimi i mundësisë së ndotjes së ajrit.
- Zvogëlimin e gazrave të rrezeve

Nga kjo rrjedh se përvoja pozitive në shfrytëzimin e mbeturinave si lëndë djegëse alternative apo lëndë të para është gjithnjë e më e madh në procese të ndryshme të prodhimit.

5. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Shkarkimet në mjedis gjate funksionimit të impiantit të prodhimit të bllokave do të jenë kryesisht pluhuri i lëndës së parë, ndotje të ajrit ndodh nga pluhuri i cili lirohet në depot për deponimin e argjilës dhe petrol koksit si dhe nga sipër faqet manipuluese me argjilë dhe petrol koks dhe ne raste të mos mirëmbajtjes së filtrave të oxhakut.

Procesi i prodhimit përfshinë edhe përdorimin e ujit, si pjesë e procesit teknologjik, kjo shërben për procesin e lagjes së materialit të përzier.

Pra në lidhje me aktivitetet e fabrikës për prodhimin e bllokave të ndërtimit nga argjila, ndikimi kryesor në mjedis mund të jetë ndikimet në ajër, ujë, tokë, zhurma.

4.8 Ndikimet në ajër

Gjatë fazës së zhvillimit të aktiviteteve prodhuese në fabrikën për prodhimin e bllokave nga argjila ndotje të ajrit ndodh nga pluhuri i cili lirohet në depot për deponimin e argjilës dhe petrol koksit si dhe nga sipër faqet manipuluese me argjilë dhe petrolkoks, ndotja e ajrit ndodhë nga gazrat të cilët lirohen nga automjetet transportuese, që nevojiten për transportimin e lëndës së parë argjilës, petrolkoksit si dhe produkteve të prodhuara.

Një hallke tjetër që mund të shkaktoj ndotje të ajrit ndodh nga gazrat të cilët lirohen nga lëndë djegëse që nevojiten për realizimin e procesit teknologjik (terjen dhe pjekjen) e produkteve të prodhuara dhe për ngrohjen e hapësirave të fabrikës gjatë stinës së dimrit.

Ndikimet nga djegia e lëndëve djegëse varen nga përbërja e kualitetit të petrolkoksit, tipit të ndezësve dhe rregulluesit të flakës dhe ndezjes, prandaj nëse është përpjesëtimi i lëndës djegëse dhe ajrit optimal atëherë në mjedis nuk do të lirohen gazra.

Pluhuri transient (fluturues) – kryesisht shkaktohet nga depot e lëndës së parë si dhe nga trafiku i brendshëm i fabrikës. Ky emision është shumë vështirë të matet, por përmes shfrytëzimit të depozitave të mbyllura dhe pastrimit të rregullt të rrugëve dhe spërkatjes së tyre me ujë këto emisione është arritur të reduktohen.

4.9 Ndikimet në tokë

Gjatë fazës së zhvillimit të aktiviteteve prodhuese në fabrikën për prodhimin e produkteve nga argjila ndotja e tokës ndodhë, nga derdhja e vajrave dhe derivateve nga automjetet transportuese, që nevojiten për transportimin e lëndës së parë argjilës dhe petrolkoksit si dhe produkteve të prodhuara dhe nga automjetet e parkuara në parkingun e

fabrikës, nga derdhja e vajrave dhe yndyrave nga mirëmbajtja e pajimeve prodhuese dhe automjeteve ngarkuese e transportuese, pluhurat që lirohen nga sipërfaqet punuese, pluhurat që lirohen nga sipërfaqet e deponive për deponimin e argjilës deponimin e petrolkoksit dhe produkteve finale, nga deponimi i pjesëve të mbetura nga proceset e prodhimit.

4.10 Ndikimet në ujë

Gjatë aktivitetit të fabrikës Rizam Holding i cili prodhon blloka dhe produkteve tjera të ndërtimit nga argjila, ndikime negative në ujë paraqiten nga derdhja e vajrave dhe lubrifikantëve nga mirëmbajtja e pajimeve dhe automjeteve ngarkuese, transportuese, (kamioneve) që nevojiten për transportimin e lëndës së parë argjilës, petrolkoksit si dhe produkteve të prodhuara, ndotjet nga mbeturinat e lëngata të cekura më lartë me derdhjen e tyre në tokë ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore me rastin e të reshurave atmosferike, ndotja e ujërave ndodh me larjen e hapësirave operacionale gjatë realizimit të proceseve teknologjike.

Duhet theksuar që në distance mbi 500m nga impianti rrjedhe Lumi Drini i Bardhë dhe në afërsi 35m rrjedhe një përroskë (rrjedhe ujore, e cila është periodike) e cila si pas të dhënave të gjoportalit të Rep. Kosovës nuk është shënuar me ndonjë emërtim.



Figura 21. Distanca në mes të L. Drini dhe impiantit.

Ndikimet tjera më të theksuara negative në ujë janë nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e ujërave të ndotura me vajra dhe detergjente të përdorura në kuzhinë

dhe lavatriqet e ndryshme, derdhja e ujërave të zeza, larja e rrugëve, e platos së autoparkingut etj.

4.11 Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë

Kompania Rizam Holding tash e disa dekada ka te vendosur impiantin ne këtë lokacion.

Ne baze te dhënave qe kemi gjetur nga raportet komunale por edhe ne daljes ne teren lokacion nuk është i evidentuar si zonë e mbrojtur e natyrës dhe as si zonë e propozuar për mbrojtje. Po ashtu kjo zonë nuk njihet si lokalitet ose habitat i llojeve të rralla bimore dhe shtazore. Megjithatë, në nivel të mikro sistemit dhe të habitatit lokal në sipërfaqe ku është duke operuar impianti, nuk do të ketë kushte për zhvillim të florës dhe faunës.

4.12 Ndikimi në vendbanime dhe popullatë

Siç e kemi potencuar me larte qe kompania operon ne këtë lokacion për dekada me radhe, deri me tani nuk ka pasur ankesa nga komuniteti përreth.

Nga shtimi i kapaciteteve te reja te prodhimit nuk pritet që të ketë zhvendosje të popullsisë, çrregullim të vendbanim apo çfarëdo efekti tjetër.

Nga veprimtaria e këtij aktiviteti mund të ndikohen shtëpitë në afërsi nga pluhuri eventual, si dhe nga zhurma. Masa të veçanta duhet të ndërmarrën në këtë drejtim, edhe pse nuk ka shtëpi ne distanca shume te afërta. Megjithatë, këto ndikime nuk janë të theksuara.

Do te ketë ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të zonës dhe ndihmon në punësimin dhe mbështetjen e komunitetit lokal.

4.13 Ndikimi nga zhurma

Zhurma shkaktohet nga aktivitetet e procesit teknologjik ne fabrikë , nga automjetet transportuese, që nevojiten për transportimin e lëndës së parë dhe produkteve të prodhuara, mirëpo për shkak se shumica e pajimeve teknologjike janë të vendosura ne hapësirat brenda objektit krijimi i zhurmës nga fabrika me objektet përcjellëse nuk ka ndikim të theksuar negativ ne mjedis dhe niveli i zhurmës do të jetë nën kufijtë e lejuar me standarde

Me shfrytëzimin e pajimeve për realizimin e procesit teknologjik ne fabrikë në bazë të standardeve të zakonshme maksimumi i zhurmës në burim do të jetë nën 90 dB.

Zhurma për zonën e banuar do të jetë plotësisht në kufijtë e vlerave standarde e cila nuk do të kalon 50 dB. Ne vijim do të paraqesim një pasqyrë tabelore te nivelit të zhurmës në

varshmëri nga distanca.

Zhurma	Distanca(m)			
	10	50	100	500
90dB-niveli Për pajisje moderne	59	45	39	25

4.14 Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Bazuar në aktivitetin e eksploatimit të lëndës së parë pra argjilës dhe prodhimin e bllokave të ndërtimit nga fabrika Rizam Holding, incidentet me ndikim ambiente në rajon nuk mund të ndodhin, sepse natyra e prodhimit është e tillë nuk përmban / përdor substanca të rrezikshme. Ndonjë incident me karakter lokal mund të ndodhin në çdo etapë të proceseve teknologjike në punishte si:

Gjatë proceseve tjera teknologjike në eksploatimin, Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese nga mekanizmi punues (mundësia plasjes së gypave hidraulik, mundësia e ndezjes). Nga aksidentet e mundshme në komunikacion gjatë transportit.

Vlerësimi i pasojave të mundshme Pasojat e mundshme për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mjedisin parashtrihen në bazë të dhënave të përfituara me analizën e cenueshmërisë. Me anë të analizës së cenueshmërisë evidentohen të gjitha entitetet dhe objektet e cenueshme në rrethinën e burimit potencial të aksidentit:

- të punësuarit në kompleks
- pjesëmarrësit në rrethinë
- objektet afariste dhe të banimit

Rrezikshmëria nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese nga mekanizmi punues nga mundësia e pëlcitjes së gypave hidraulik, mundësia e ndezjes, nga aksidentet e mundshme në komunikacion gjatë transportimit të lëndës së parë pra argjilës dhe prodhimeve finale është evidente nëse gjatë punës nuk i kushtohet kujdes dhe ato rrjedhin në mjedis. Nëse merren të gjitha masat paraprake për pengimin e rrjedhjeve të karburanteve dhe lubrifikantëve gjasat për të ndodhur ndonjë ndotje eventuale janë të vogla. Analiza e trungut të ngjarjeve Ngjarjet të cilat pasojnë në rastet aksidentale mund të kenë karakteristika të ndryshme.

Në vijim do të paraqesim disa nga mundësit e zhvillimit të ngjarjeve gjatë aksidentit.

- Reja e formuar lëvizë teposhtë:
- inicimi ndodh menjëherë krahas formimit të resë së zjarrtë
- largohet nga rezërvvari dhe vjen deri te inicimi ose eksplodimi i resë
- nuk vjen deri te inicimi

5. MASAT PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE NË MJEDIS

5.1 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për të parandaluar dhe zvogëluar ndikimet negative në ajër gjatë fazës së operimit, përkatësisht prodhimit të bllokave dhe produkteve që dalin nga argjila, për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në ajër duhet të ndërmerren këto masa:

- Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të prodhimit duhet të mënjanohet apo zvogëlohet deri në kufijtë minimal dhe pa ndikime në mjedis dhe shëndet.
- Shiritat transportues të fraksioneve duhet të jenë të mbuluar, dhe të mirëmbajtur.
- Thasët e filtrave të kontrollohen rregullisht dhe nëse dëmtohen duhet të ndërrohen.
- Të bëhet kontrolli i rregullt teknik i automjeteve transportuese.
- Vazhdimisht të spërkaten me ujë platoja operationale, aty ku ka potencial për pluhur, sidomos gjatë kohës me erëra dhe me temperatura të larta.

Ndërsa masat primare që duhet aplikuar në fabrike janë si:

- Instalimin Cikloni (shpluhurimi centrifugal), me shkallë shpluhurimi rreth 80%;
- Venturi me sistem të mbyllur të ujit;
- Skruberi (shpëlarje me pika uji);
- Filtri me kartrixh, i përbërë nga materialet sintetike që rezistojnë temperatura të larta (200- 250 °C).

5.2 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë

Për të parandaluar dhe zvogëluar ndikimet në tokë, gjatë fazës së operimit, duhet të ndërmerren masat si në vijim:

- Të gjitha pajimet, stabilimentet e nevojshme për procesin e prodhimit të mirëmbahen dhe kontrollohen rregullisht;
- Filtrat e parandalimit të ndotjes së ajrit duhet të kontrollohen dhe nëse janë dëmtuar të ndërrohen;
- Të kontrollohen gypat transportues si dhe shiritat transportues. Vendet e lidhjes së gypave duhet të jenë të puthitura mirë në mënyrë që të parandalohet rrjedhja e materialeve.
- Të bëhet betonimi i platosë ku bëhet vendosja e pajimeve për prodhimin;
- Të bëhet betonimi i vendeve ku janë të vendosur si; gjeneratori, depot e vajrave e lubrifikantëve dhe të pajimeve tjera, si mjete sekondare të punës;

- Ndërrimi i vajrave të makinave të bëhet në vende të posaçme, të betonuara dhe të izoluara;
- Mbeturinat e ngurta duhet të grumbullohen dhe klasifikohen sipas llojit dhe përbërjes. Ato që nuk mund të ripërdoren apo të shiten duhet të dërgohen në deponime regjionale të mbeturinave;
- Mbeturinat komunale duhet të vendosen në kontejner adekuat të mbuluar me kapak, dhe duhet të bëhet marrëveshje me kompaninë komunale për mbledhje të mbeturinave;
- Vajrat e përdorura duhet të vendosen në enë të veçanta dhe t'u shiten kompanive të licencuara për mbledhjen e vajrave të përdorura.

5.3 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë

Uji në fabrikë përdoret për proces të prodhimit një sasi të ujit ja shtojmë Argjilës, pastaj përdoret për pije dhe Sanitari. Nga procesi teknologjik nuk kemi shkarkime të ujerave. Vetëm ujërat sanitar mundë të jenë potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësor.

Për pastrimin e sipërfaqeve manipuluese kemi sasinë si më poshtë:

$$Q_{\text{pastrim}} = 0.15 \text{ l/s, dhe}$$

Sasia totale e shkarkimit nga sipërfaqet manipuluese është $Q_{\text{tot}} = (0.15 +) = 0.15 \text{ l/s,}$

$$Q_{\text{ujet}} = q_{\text{s,k maks}} * 150 \text{ ditë/vit} = 0.15 \text{ l/s} * 150 \text{ ditë/vit} * 1/1000 \text{ m}^3/\text{s} * 10 \text{ h/dite} * 60 \text{ min./h} * 60 \text{ s/min.} = 810 \text{ m}^3/\text{vit.}$$

Ndërsa sa i përket procesit teknologjik, shfrytëzimi i ujit nuk përdoret fare në procesin teknologjik dhe për këtë nuk kemi sasi të shkarkimit nga procesi teknologjik.

Për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve negative në ujëra, duhet ndërmarrë këto masa:

- Në punishte duhet të behët sistemi për bartjen dhe grumbullimin e ujërave të ndotura të krijuara nga larja e automjeteve transportuese apo automjeteve të tjera, si dhe të ujërave të reshurave atmosferike;
- Duhet rregulluar sistemin gypor për bartjen e ujërave të cilat duhet të barten në puse sedimentuese për trajtimin e ujërave, përkatësisht për sedimentimin e grimcave të ngurta;
- Kolektorët duhet të rregullohen ashtu që e tërë sasia e ujërave fekale si dhe të reshurave nga platotë dhe nga tërë sipërfaqet funksionale të grumbullohen dhe të orientohen në pusët sedimentuese, e pastaj në separator.
- Duhet të ndërtohen tri puse sedimentuese në mënyrë që të sedimentohen grimcat e ngurta;
- Duhet të ndërtohet separatori i vajrave në mënyrë që ujërat të pastrohen nga vajrat që kanë rrjedhur nga sipërfaqet operacionale, makineritë prodhuese, automjetet etj. Separatori duhet të ndërtohet ashtu që rregullisht të mund të kontrollohet dhe të merren mostrat;

- Puset sedimentuese dhe separatori duhet rregullisht te pastrohen nga mbeturinat;
- Mbeturinat duhet të dërgohen në deponi regjionale;
- Ujërat e zeza duhet të trajtohen përmes gropës septike. Pastrimi i gropës septike duhet të bëhet nga kompanitë publike për ujësjellës dhe kanalizim;
- Kompania duhet që të matjen e cilësisë së ujërave të shkarkuara, dhe se vlerat e fituara duhet të krahasohen me vlerat e caktuara me udhëzimin administrativ 13 / 2008. Vlerat e cilësisë së ujit të shkarkuar nuk guxojnë të jenë më të larta se ato të përkufizuara në udhëzim administrativ.




Figura 22. Skica gropës septike e cila është ndërtuar.



Figura 23. Skema e trajtimit te ujërave (kjo skam është ndërtuar tani).

5.4 Masat për mbrojtjen nga Zhurma

Kompania duhet të bëjë matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Matjet duhet të bëhen afër vendbanimeve, në mënyrë që të vërehen ndikimet në vendbanim.

Në rast se rezultatet e matjeve tregojnë vlera më të larta sesa ato të lejuarat, atëherë kompania duhet të ndërmarrë masat e duhura.

Varësisht prej procesit të punës, në mjediset ku parashihet zhurmë e madhe, punëtorët duhet të bartin pajisje për mbrojtje nga zhurma.

5.5 Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet

Për të parandaluar pasojat e mundshme, kompania duhet të zhvilloj plan të menaxhimit të rrezikut nga aksidentet mjedisore. Gjithashtu duhet të përgatit një plan për parandalimin e zjarrit, por edhe plan për menaxhimin e situatave në raste të zjarrit.

Të hartohet rregullorja ku do të definoohen procedurat për rastet aksidentale, të bëhet aftësimi i të punësuarve dhe të caktohen obligimet e tyre në situata aksidentale.

Në mënyrë permanente të mirëmbahet ambienti në kompleksin e fabrikës për prodhimin e bllokave për ndërtim “Rizam Holding” sh.p.k. duhet të i marr këto masa:

- Është obligim që rezervuarët e naftës, mazutit, gazit të kontrollohen brenda pesë viteve të para të punës për të përcjellë dëmtimet e trashësisë

së mureve nga veprimi koroziv. Pas pesë viteve kontrolli duhet të bëhet për çdo dy vite.

- Pronari është i detyruar të mbanë evidencën dhe ruan shënimet për shitjen e produkteve finale dhe emrin e kompanisë e cila i ka pranuar.
- Evidenca dhe shënimet duhet të mbahen sipas rekomandimeve që jepen në Ligjin për Mbeturina Nr. 02/L-30, Udhëzimin Administrativ për administrimin e vajrave të përdorura mbeturinë (03/07) dhe Udhëzimeve administrative relevante të miratuara sipas rekomandimeve nga Ligji për Mbeturina Nr. 02/L-30.

Fabrika “Rizam Holding” sh.p.k ne Krush të Vogël do të bazohet në standarde më të larta të menaxhimit me mjedis. Për këtë arsye me qëllim të reduktimit të emisioneve ose evitimin e incidenteve të padëshirueshme janë të instaluar sistemet e vetëkontrollit për reagim efikas në çfarëdo lloj situatash si:

- Sistemin e alarmit kundër zjarrit
- Sistemin e fikjes së zjarrit me ujë (sistemi i hidrantëve)
- Sistemin e fikjes së zjarrit me CO2
- Sistemin e fikjes së zjarrit në ormanët shpërndarës të energjisë elektrike

Është i zhvilluar edhe instaluar plani për intervenim në situatë të jashtëzakonshme, në të cilin janë të përcaktuar grupet dhe personat përgjegjës për menaxhim në situatë të jashtëzakonshme në të cilin janë të përfshirë:

- Ekipi menaxhues për menaxhimin në situatë të jashtëzakonshme
- Ekipi për mbrojtjen kundër zjarrit
- Ekipi i ndihmës së parë
- Grupet profesionale sipas ndërrimeve

Varësisht nga rasti i jashtëzakonshëm dhe pasojat e tyre të mundshme, me planin e veprimit do të definohen vendtakimet e punëtorëve për evakuim dhe punëtorëve të lënduar nga hapësirat e objekteve ose reparteve punuese të fabrikës.

6. PROGRAMI I MONITORIMIT

Kompania “Rizam Holdig” do të bënë monitorimin periodik të emisioneve në ajër, ujërave dhe zhurmës këto matje dhe monitorime do bëhet nga Instituti INKOS.

- Për ajrin duhet të monitoroj Lëndën e Ngurtë Pezull(LNP)
- Zhurmat në ambientin e punës dhe jashtë (dB).
- “Rizam Holding” do të bënë monitorimin periodik të emisioneve në ajër (grimcat fluturuese, NO_x , SO_2 ,Komponimet organike të avullueshme, ujërat e ndotura sipas planit për vetmonitorim.
- Kontrolli i ujërave të ndotura nga fabrika bëhet përmes monitorimit periodik dy herë në vit të parametrave kryesor për ujë të ndotura të cilat do të realizohen nga instituti INKOS.

7. RAPORTIMI

Raportimi do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxhmenti, gjegjësisht nga ekspertët e kompanisë. Në raport do të përfshihen të dhënat për monitorimin siç do të jetë kërkuar në pëlqimin mjedisor, përkatësisht lejen mjedisore e integruar.

8. MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT

Pas përfundimit të aktivitetit prodhues, pajimet e impiantit duhet të çmontohen dhe të largohen nga ky lokalitet. Bazamentet si dhe platotë nga betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponinë regjionale. Substratet e krijuara gjatë procesit të prodhimit, përmbajnë rërë, zhavorr, çimento beton etj. Ato duhet të largohen, dhe me një trashësi rreth 0.5 m struktura përfundimtare duhet të jetë e mbuluar me dheun, e cila është adekuate me dheun e mëparshëm dhe ku do të përshtatet substratit të tokës.

Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara apo të degraduar nga ndryshimi i destinimit do të përfshijë rivitalizimin në tërësi të hapësirës së dëmtuar nga veprimtaria ekzistuese. Zgjedhja e rikultivimit dmth modelit, varet edhe nga qëllimi i përdorimit të tokës, siç do të jetë e paraparë me planet komunale.

9. KONKLUZION

Me respektimin e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, ndikimi i impiantit për prodhimin e bllokave dhe elementeve tjera të ndërtimit që dalin nga argjila do të jetë në nivel të vlerave dhe standardeve të caktuara me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

Ndikimet e evidentuara janë të menaxhueshme dhe kontrollueshme. Këto ndikime do të monitorohen dhe do të raportohen në fund të çdo viti kalendarik, dhe sipas kërkesave të autoriteteve përkatëse.

REFERENCAT

- PZHK Prizren.
- Çavolli. R. 1997, Gjeografia regjionale e Kosovës.
- UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor, Kosovë, 2004.
- Regjistrimi i Popullsisë, Agjencia e Kosovës për Statistika.
- Ligji i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.
- Raport për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë, 2008-2010, AMMK 2011.
- Raport për Gjendjen e Natyrës në Kosovë, 2009, AMMK 2010.
- Te dhënat nga investitori Rizam Holding Sh.p.k.